



MENAXHIMI I INTEGRUAR I RESURSEVE UJORE NË KOSOVË SKEMA E GRANTEVE KONKURUSESE FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT

Për pjesëmarrjen në programin e trajnimeve dhe granteve për të mbështetur vendosjen e masave agro-ekologjike për menaxhimin e plehut organik në pellgjet e lumit Ibër, Moravë e Binçës dhe Lepenc

Granti do të ndahet si vijon:

- **Ndërtimi i plehrishteve** (varësisht nga tipi dhe kapaciteti i shtallës);
- **Pajisjet përcjellëse në fermë** (mekanizëm si mikser për gropë septike, rimorkio për shpërndarjen e plehut dhe cisternë për shpërndarjen e plehut të lëngët) .



MENAXHIMI I INTEGRUAR I RESURSEVE UJORE NË KOSOVË SKEMA E GRANTEVE KONKURUSESE FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT

Për pjesëmarrjen në programin e trajnimeve dhe granteve për të mbështetur vendosjen e masave agro-ekologjike për menaxhimin e plehut organik në pellgjet e lumit Ibër, Moravë Binçës dhe Lepenc

Programi i financuar nga Zvicra **Menaxhimi i IntegrUAR i Resurseve Ujore në Kosovë (MIRU-K)** (në tekstin e mëtejshëm Programi ose MIRU-K) synon të ndërtojë kapacitete afatgjata të menaxhimit të resurseve ujore në nivel kombëtar në pellgjet lumenjë në përputhje me prioritetet socio-ekonomike dhe politike të Kosovës, si dhe nevojat e ardhshme të zhvillimit qëndrueshëm. Programi synon të ndihmojë në zëvendësimin e qasjes aktuale e cila është fragmentuar me një qasje më gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjet e lartë në menaxhimin e resurseve ujore në shkallën e pellgut të lumenjëve, duke përfshirë me parimet e MIRU dhe **Direktivën Kornizë të Ujrave të BE -së (EU WFD)**.

Pjesë e rëndësishme e Programit janë aktivitetet që synojnë qasje të ndryshme (prototipe) si dhe praktikave **për zvogëlimin e ndikimeve (presioneve) nga ndotja që vije nga bujqësia** në zonat e zgjedhura të Kosovës.

Si pjesë e **Skemës së Granteve Konkurruese (SGK)**, Programi tani fton fermerët e interesuar të **paraqesin aplikimet** për pjesëmarrje në një program trajnimi dhe një program të mëvonshëm të granteve.

Trajnimet do të zhvillohen **në objektin e Fermës “EuroLona” në Fushë Kosovë**. Transporti për në vendin e trajnimit, pavarësisht nga cila komunë vijon është përgjegjësi e vetë fermerëve të përzgjedhur.



Meanë të kësaj **Thirrje**, programi synon të zgjedhë deri në **40-50 ferma blegtoriale**. Përzgjedhja e kandidatëve (fermave) do të bëhet sipas **kritereve të paracaktuara**. Fermerët e përzgjedhur do të bëhen partnerë të projektit në zbatimin e praktikave moderne bujqësore, të dizajnuara për të zvogëluar ndikimet negative në mjedis dhe për të përmirësuar nivelin e menaxhimit të plehut organik.

Zbatimi i trajnimit do të pasohet nga **një test për të vlerësuar njohuritë e fituara** të kërkuara për nevojat e zbatimit të praktikave të rekomanduara bujqësore. Bazuar në rezultatet nga testi, dhe sipas kritereve të tjera do të përzgjidhen **gjithsej 30-35 fermerë** nga të gjitha komunat e synuara dhe do të bëhen **përfitues të grantit** të Programit.

Granti do të ndahet si vijon:

- **Ndërtimi i plehrishteve** (varësisht nga tipi dhe kapaciteti i shtallës);
- **Pajisjet përcjellësenë fermë** (mekanizëm si mikser për gropë septike, rimorkio për shpërndarjen e plehut dhe cisternë për shpërndarjen e plehut të lëngët).

Secili nga përfituesit e përzgjedhur të granteve do të monitorohet në **tre vitet e ardhshme** dhe do të jetë i obliguar të zbatojë teknikat e sugjeruara të menaxhimit të plehut të shtallës. Gjatë kësaj kohe, ekspertët e jashtëm do të jetë në dispozicion të fermerëve për **trajnime praktike dhe mbështetje specifike sipas kërkesës**.

Propozimi për llojin e pajisjeve dhe materialeve që do të financohen nga Programi do të bëhet nga një ekip ekspertësh. **Prokurimi i pajisjeve dhe materialit të nevojshëm do të kryhet nga Programi** (nuk parashikohen transferime në para të gatshme për fermerët e përzgjedhur).

Trajnimet do të organizohen në muajin Maj-Qershor 2023, ndërsa testimi do të organizohet gjatë muajit **Qershor 2023**. Materialet e nevojshme për t'u përgatitur për testin do të jenë në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve në trajnim.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve:

1. Aplikacioni i kompletuar;
2. Kandidati duhet të jetë mbi moshën 18 - 65 vjeç;
3. Vendndodhja e **fermave blegtoriale** duhet të jetë në njërin nga **pellgjet e synuara të lumenjve: Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc**. - një listë e komunave nga të cilat fermerët kanë të drejtë të aplikojnë është bashkangjitur.
4. Kandidati duhet të jetë një fermer individual me numrin e tij të regjistrimit të fermës (NIF), ose regjistrim biznesi;
5. Të ardhurat e familjes nga aktiviteti bujqësor të jenë së paku 30% të të hyrave totale të familjes në vitin e mëparshëm.
6. Kandidati/ja duhet të jetë pronar i tokës, të ketë dokumentacionin e pronës që i përket një familje të ngushtë (vi e drejt e gjakut) ose të ketë lidhur një marrëveshje qiraje për një periudhë të paktën 5 vjeçare duke filluar nga periudha e lidhjes së marrëveshjes me Programin;
7. Ferma duhet të ketë së paku 5 krerë lopë qumështore, 10 krerë dema (mbi 6 muaj) ose fermat e përziera së paku 10 krerë lopë dhe viça;
8. Sipërfaqja e tokës që punon të jetë në proporcion me kapacitetin e fermës (min 0.30 ha për lopë qumështore dhe 0.20 ha për dema). Dëshmohet me listën e aplikimit për subvencione të vitit 2023.

Në rastin e paraqitjes së një numri të madh të aplikacioneve, krahas kritereve të më sipërme, do të aplikohen kritere shtesë në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis për renditjen e kandidatëve (si p.sh., struktura e fermës, vendndodhja në lidhje me zonën ekzistuese të mbrojtur, sistemi i prodhimit në shtallë, burimi i ujit për pije, dhe kritere të tjera).

Në rast të pikëve të njëjta në renditje, përparësi do t'i jepet familjeve me një pjesë më të madhe të të hyrave nga aktiviteti bujqësor dhe aplikuese femra.

Aplikacioni për pjesëmarrje në program, mund të merret në formë elektronike duke klikuar [këtu](#). Poashtu, kopjet fizike të aplikacionit (të printuara mund të merren nga zyrat e SHPQK-së, Bulevardi Bill Klinton 112/11 Prishtinë, apo në zyret e Skat Consulting Kosovo, 136 Rruga Pashko Vasa, kati 1, nr 5, Prishtinë, Republika e Kosovës. Nëse bëhet aplikimi në formatin e shtypur, aplikimi i plotësuar duhet të dorëzohet në dy kopje (në një nga gjuhët zyrtare): një (1) kopje origjinale dhe një (1) kopje, **jo më vonë se 30 Prill 2023** tek adresa:

Bulevardi Bill Klinton 112/11 Prishtinë, Republika e Kosovës

e-mail: projektivkamp@gmail.com

Aplikacioni duhet të dorëzohet me emrin:

"Aplikimi për trajnim dhe grant për masat agro-mjedisore për menaxhimin e plehut organik"

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në formë elektronike (projektivkamp@gmail.com), ose drejtpërdrejt (me dorë) në zyret e SHPQK-së. Për informacion më të detajuar në lidhje me kushtet dhe kriteret e njoftimit, ju lutemi kontaktoni:

Personi kontaktues: Driton Sylejmani, nr. i kontaktit +383 (0) 44191200

Shënim:

Bashkangjitur në këtë njoftim do të gjeni:

1. Formularin e aplikimit;
2. Listën e komunave për pellgun lumenj, të cilëve të cilëve kanë të drejtë për aplikim;
3. Harta e pellgjeve të lumenjve dhe komunave sipas pellgjeve të lumenjve.



Programi MIRU-K është duke u zbatuar nga SKAT Consulting Kosovo

Zbatimi i këtij aktiviteti të veçantë - Prezantimi i praktikave miqësore me mjedisin për menaxhimin e plehut në fermat blegtorale në Kosovëpo mbështetet nga Shoqata e Prodhuesvetë Qumështit të Kosovës (SHPQK).



Forma e aplikimit

Për pjesëmarrjen në programin e trajnimeve dhe granteve për të mbështetur vendosjen e masave agro-ekologjike për menaxhimin e plehut organik në pellgjet e lumit Ibër, Moravë e Binçës dhe Lepenc

Informata të përgjithshme:

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

Adresa e plotë: _____, / **Lokacioni:** ☐ Ibër, ☐ Morava e Binçës, ☐ Lepenc

Numri i kontaktit (telefon): _____,

E-mail adresa: _____,

Mosha e kandidatit: ☐ 18 – 40; ☐ 41 – 65.

Numri i anëtarëve të familjës: ☐ 0 – 4; ☐ 4 – 6; ☐ 7 ose mbi 7 anëtaë.

Informata mbi strukturën e fermës etj:

Struktura e fermës:

- ☐ Ferma e lopëve qumështore (LQ)
- ☐ Fermë demash (viça për trashje-VT)
- ☐ Ferma e përzier (lopë dhe dema)

Numri i bagëtive (kafshëve) në fermë:

- ☐ L.Q (Lopë qumështore) 5 - 15 krerë ose ☐ 10 - 15 krerë V.T (V.T vica per trashje / dema)
- ☐ 16 - 25 krerë
- ☐ Mbi 26 krerë

Mënyra e mbajtjes së bagëtive (kafshëve) në fermë:

- ☐ Sistemi i lirë i mbajtjes
- ☐ Sistemi i lidhur i mbajtjes

Distanca e fermës nga lumi, liqeni ose kanali vaditës:

- ☐ 0 - 1 Km
- ☐ 1 - 5 Km
- ☐ Mbi 5 km

Pronësia e tokës:

- ☐ Tokë në emër të aplikuesit
- ☐ Tokë e trashëguar
- ☐ Tokë me qera



Sipërfaqja e tokës që punon:

- ☐ 2.5 - 5 Ha
- ☐ 6 – 10 Ha
- ☐ Mbi 10 Ha

Të ardhurat e familjes nga aktiviteti në blegtori:

- ☐ 30% - 50%
- ☐ 51% - 80%
- ☐ 81% - 100%

Burimi i ujit për pije:

- ☐ Pusi (Bunari)
- ☐ Ujësjiellësi

Të dhëna të tjera:

A posedoni depo të plehut:

- ☐ Po
- ☐ Jo

Nese "PO", ju lutem specifikoni llojin e depos së plehut që posedoni:

☐ Depo e plehut të lëngët (Gropë septike):

☐ Depo e plehut të ngurtë;

☐ Të dy llojet e depove të plehut.

A keni perfituar ndonjë grant në 3 vitet e fundit:

- ☐ Po
- ☐ Jo

Nese "PO", ju lutem specifikoni llojin e grantit:

☐ Ndërtim i shtallës;

☐ Renovim;

☐ Mekanizëm;

☐ Mekanizëm dhe Ndërtim/Renovim.



Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Aplikacioni i kompletuar;
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Pëlqimi i nënshkruar për përdorimin e kopjeve të dokumenteve personale (dokumenti i bashkangjitur);
4. Lista e pronësisë (Fletaposeduese) për parcelën ku është e ndërtuar ferma;
5. Marrëveshja e qirasë për parcelën e raportuar ose deklarata për vi të drejtë të gjakut (nëse parcela është me qira ose e trashëguar);
6. Çertifikatat për vi të drejtë të gjakut (nëse parcela është e trashëguar);
7. Çertifikata e regjistrimit në regjistrin për identifikimin ekafshëve me numër të gjedheve (lëshuar nga Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV);
8. Aplikacioni për pagesa direkte të vitit 2023.

Dokumentet duhet të dorëzohen nga dy kopje, një në origjinal dhe nga një kopje për secilin dokument.

Nëse kandidati përzgjidhet, pjesëmarrja në programin e trajnimit është e detyrueshme dhe është një parakusht për t'u marrë parasysh për skemën e granteve.

Nënshkrimi: _____

Data e dorëzimit : _____



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government


Forma e pëlqimit

Unë _____, me numër
personal _____,
me adresë
_____.

Unë pajtohem qëSHPQK të bëjë një kopje të letërnjoftimit dhe dokumenteve të tjera përcjellëse me të dhënat e mia personale që do të përdoren ekskluzivisht për thirrjen për pjesëmarrje në programin e trajnimitdhe granteve për vendosjen e masave Agro-Ekologjike për menaxhimin e plehut organik në fermat blegtorale në pellgjet e lumit Ibër, Morave e Binçës dhe Lepenc.

Vendi _____ Data _____

(nënshkrimi)





Lista e komunave për pellgjet e lumenjëve, fermerët e të cilëve kanë të drejtë për trajnim dhe grante

<u>Pellgu Ibër</u>	<u>Komuna</u>	<u>Pellgu i Lepencit</u>	<u>Komuna</u>	<u>Pellgu i Moraves së Binçës</u>	<u>Komuna</u>
	Prishtinë		Ferizaj		Gjilan
	Podujevë		Kaçanik		Kamenicë
	Obiliq		Shtërpce		Ranillug
	Fushë Kosovë		Hani i Elezit		Novobërdë
	Vushtrri				Partesh
	Glllogoc				Klllokot
	Graçanicë				Viti
	Lipjan				
	Shtime				
	Skenderaj				
	Mitrovicë				
	Mitrovicë e Veriut				
	Zveçan				
	Zubin Potok				
	Leposavic				